



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2208 Prot.

Lezhë, më 02.03. 2026

VENDIM

Nr. 18, Datë 25. 02. 2026

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË FONDIT PYJOR  
KOMBËTAR, SHOQËRISË ONE ALBANIA SHA, PËR ANTENAT E TELEFONISË  
CELULARE, FSHATI BALLDRE, NJËSIA ADMINISTRATIVE BALLDRE DHE FSHATI  
MABË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DAJÇ, BASHKIA LEZHË**

Bazuar në Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", Udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit të Mjedisit, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullor kombëtar", pas shqyrtimit të dokumentacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

**Vendosi:**

1. Dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar me kontratë qiraje për antenën e telefonisë celulare me kod LE1004, shoqërisë **ONE ALBANIA SHA**, në fshatin Balldre, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë, sipas raportit tekniko-ekonomik bashkangjitur. Sipërfaqja pyjore dhe segmenti rrugor ekzistues që jepen në përdorim detajohen si mëposhtë:
  - **0.02 ha** sipërfaqe pyjore për antenën e telefonisë celulare, në ngastrën pyjore **18b**, ekonomia pyjore "Mali i Kakarriqit".
  - **0.31 km** rrugë ekzistuese, në ngastrën pyjore **18b**, ekonomia pyjore "Mali i Kakarriqit".
  - **0.31 km** rrugë ekzistuese, në ngastrën pyjore **17a**, ekonomia pyjore "Mali i Kakarriqit".

- **0.39** km rrugë ekzistuese, në ngastrën pyjore **17b**, ekonomia pyjore “Mali i Kakarriqit”.
  - **0.05** km rrugë ekzistuese, në ngastrën pyjore **15h**, ekonomia pyjore “Mali i Kakarriqit”.
  - **1.08** km rrugë ekzistuese, në ngastrën pyjore **16**, ekonomia pyjore “Mali i Kakarriqit”.
  - **0.29** km rrugë ekzistuese, në ngastrën pyjore **32**, ekonomia pyjore “Mali i Kakarriqit”.
2. Dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar me kontratë qiraje për antenën e telefonisë celulare me kod SH2006, shoqërisë **ONE ALBANIA SHA**, në fshatin Mabë, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë, sipas raportit tekniko-ekonomik bashkangjitur. Sipërfaqja pyjore dhe segmenti rrugor ekzistues që jepen në përdorim detajohen si mëposhtë:
- **0.02 ha** sipërfaqe pyjore për antenën e telefonisë celulare, në pasurinë numër **1** zona kadastrale **1533**.
  - **0.501** km rrugë ekzistuese, në pasurinë numër **1** zona kadastrale **1533**.
3. Afati për dhënie në përdorim është **5** vite me vlerë qiraje **264350** (dyqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë/vit për antenën me kod LE1004 dhe afati për dhënie në përdorim është **5** vite me vlerë qiraje **195050** (njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë) lekë/vit për antenën me kod SH2006.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

**SEKRETARI**  
**FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI**  
**NDUE LULI**





## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIKNr. 212/10 Prot.Lezhë, më 09.03.2026

**Lënda: Kthim përgjigje në lidhje me vendimin nr.18, datë 25.02.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë**

## KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

## KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Në përgjigje të shkresës suaj me nr.2815 prot, datë 02.03.2026 "Dërgim vendimesh të Këshillit të Bashkisë Lezhë", protokolluar në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë me nr.212 prot, datë 02.03.2026, bazuar në nenet 8 dhe 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" të ndryshuar, pasi shqyrtuam vendimin nr.18, datë 25.02.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit Pyjor Kombëtar, shoqërisë One Albania sha, për antenat e telefonisë celulare, fshati Balldre, njesia administrative Balldre dhe fshati Mabë, njesia administrative Dajç, Bashkia Lezhë" si dhe dokumentacionin bashkëngjitur këtij vendimi konstatojmë si më poshtë:

Së pari: Ky vendim në bazë të nenit 3, pika 2 të ligjit nr 44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" nuk është akt me karakter normativ. Vendimi nr.18, datë 25.02.2026 i Këshillit të Bashkisë Lezhë është akt administrativ individual pasi i drejtohet një subjekti të përcaktuar individualisht (subjekti që do të marrë me qira sipërfaqen pyjore dhe konkretisht shoqëria One Albania sha (qiramarrës në vazhdimësi), krijon një marrëdhënie juridike konkrete dhe ka një pasojë konkrete (vendosja e antenave të telefonise celulare në një sipërfaqe pyjore të dhënë dhe me parë me qira), si dhe është i shteruar në zbatimin e tij (përfundon brenda 5 viteve).

Në bazë të nenit 8 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" të ndryshuar; a) Në ushtrim të funksionit të tij, prefekti i qarkut ka këto përgjegjësi kryesore:

-Verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Referuar nenit 4 të ligjit nr.107/2016, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Akte me karakter normativ" janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të

vazhdueshme dhe jo të njehershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.

Së dyti : Vendimi nr.18, datë 25.02.2026 i Këshillit të Bashkisë Lezhë referuar relacionit dhe raportit teknik bashkëngjitur nuk ndryshon kategorinë e përdorimit të fondit pyjor pasi ka të bëjë me rinovim kontrate dhe si i tillë nuk i nënshtohet procedurës së parashikuar në pikën 2 germa “d” të kreut III të VKM-së nr. 888, datë 27.12.2022.

Sqarojme se: Vetëm në rastet kur dhënia në përdorim dhe ndryshimi i kategorisë së përdorimit të fondit pyjor kombëtar, ndryshimi i sipërfaqeve pyjore dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimi i tyre i nënshtrohet procedurës së parashikuar në pikën 2 germa “d” të kreut III-të të VKM-së nr. 888, datë 27.12.2022“Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, pavarësisht natyrës së vendimit të Këshillit të Bashkisë ( individual apo kolektiv) Prefekti i Qarkut shprehet mbi ligjshmërinë e këtij akti .

Për sa më sipër verifikimi ligjor i vendimit nr. 18, datë 25.02.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “ Për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit Pyjor Kombëtar , shoqërisë One Albania sha , për antenat e telefonisë celulare , fshati Balldre , njesia administrative Balldre dhe fshati Mabë, njesia administrative Dajç , Bashkia Lezhë“ si një akt administrativ individual nuk i nënshtrohet verifikimit ligjor nga ana e Prefektit por hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Taulant MALSHI**

